



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

DEKLARATË PUBLIKE
E KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK LIBOHOVË
“Për Për mirësimin e transparencës dhe Rritjen e Besimit Publik”

Në funksion të forcimit të qeverisjes vendore, rritjes së besimit të qytetarëve dhe garantimit të një administrimi sa më të hapur dhe të përgjegjshëm, Këshilli Bashkiak Libohovë angazhohet publikisht për përmirësimin e vazhdueshëm të transparencës institucionale dhe komunikimin me qytetarët.

Transparenca përbën një nga shtyllat kryesore të një administrate moderne dhe efektive. Për këtë arsye, Këshilli Bashkiak do të ndërmarrë masa konkrete për publikimin në kohë reale të vendimeve dhe akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak, rritjen e aksesit të qytetarve në informacionin publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi zhvillimin e konsultimeve publike për çështje me interes për komunitetin përmirësimin e komunikimit institucional me qytetarët organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, forcimin e mekanizmave monitoruese dhe të kontrollit për garantimin e llogaridhënies përdorimin më gjerë të platformave elektronike dhe mjeteve dixhitale për informimin e publikut.

Gjithashtu, do të punohet për rritjen e standarteve të integritetit institucional, etikës administrative dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimarrëse, me qëllim krijimin e një administrate më të hapur, më të përgjegjshme dhe më pranë qytetarve.

Këshilli i Bashkisë Libohovë mbetet i angazhuar për të garantuar një qeverisje vendore transparente, gjithëpërfshirëse dhe në shërbim të interesit publik.

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj